



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-15923/20 datë:19.08.2020



Npi – 01/176 datë: 31.08.2020

Duke u bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafin 12.2, pika (c) dhe nenin 17, pika (s) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), si dhe në bazë të Statutit të Komunës së Shtimes 01 Nr.06/1636 të datës 03.09.2008. Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 31.08.2020 mori këtë:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E RREGULLORES KOMUNALE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -VI- të rregullt për vitin 2020, të mbajtur më: 31.08.2020, unanimisht aprovoi, Rregulloren Komunale për mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve.

II


Rregullorja Komunale për mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve, është aprovuar pas procesit të diskutimit publik me qytetarë, si dhe duke marrë për bazë Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

III

Ky vendim bashkë me rregulloren hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi bashkë me Rregulloren u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj